VIDEO/ U raportua si aksidentale, djali vret babain në Selenicë, i vuri tritol në sobën e gazit! 23-vjeçari: Më dhunonte vazhdimisht

I moshuari i verbër që humbi jetën nga një shpërthim në oborrin e shtëpisë në fshatin Gjorm të Vlorës, është vrarë nga vetë djali i tij. Skenari që u tentua të fshihet si aksidental, u zbulua nga hetuesit, të cilët thanë se 23-vjeçari Mato Gllucaj nga fshati Gjorm i Vlorës, vendosi të vrasë babain, pasi dhunohej prej tij. Ai vendosi kallëpe me tritol brenda një sobe gazi dhe i shpërthetu sapo babai ishte afër

HOROSKOPI

Lajmi i fundit

'Plas' mes Romës dhe Parisit! Ish-kryeministri italian: Raketa franceze rrëzoi një aeroplan në vitin 1980 aksidentalisht në përpjekje për të vrarë Gadafin

2 Shtator, 18:00

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
2 Shtator, 13:34 | **Përditësimi: 2 Shtator, 14:45**

Share

Policia ishte e paqartë, nëse 56-vjeçari nga fshati Gjorm i Vlorës, ***Durmish Gllucaj***, humbi jetën nga shpërthimi me eksploziv, apo bombola e gazit. Ajo që bluté nuk dinin, ishte se të dyja këto pista, ishin në fakt pjesë e asaj që në fillim u raportua aksidentale, por që doli një skenar vrasje.

Djali 23-vjeçar i shtëpisë, Mato Gllucaj kishte orgnaizuar gjithçka. Në sobën me gaz që e mbanin në oborrin e shtëpisë, kishte vendosur lëndë eksplozive. Sapo babai i është afruar sobës, djali e ka shpërthyer përmes një mekanizmi elektrik.

LEXO EDHE:
'Verë e pafundme', Dua Lipa rikthen momentet më të bukura nga pushimet

Shpërthimi ishte i fortë, saqë për të kontrolluar nëse reth banesës mund të kishte lëndë të paplasura, në fshat shkuan dhe forcat xheniere, por djali duket të ketë larguar cdo gjurmë të lëndës shpërthyese nga soba. Por çfarë e shtyu djalin të vrasë babanë? Policia thotë se 23-vjeçari dhunohej vazhdimisht prej kryefamiljarit. Për të shpëtuar prej dhunës së Durmish Gllucajt, i cili ishte dhe i verbër, djali ka bërë planin hakmarrës.

Policia nuk pristë që brenda banesës së tragjedisë të fshihej një skenar i tillë, dhe aq më pak një arsenal i tërë armatimesh që u sekuestrua: 25 granata dore difensive, 37 kallëpe me lëndë plasëse tritol, 43 kapsolla detonatore, 5 ndezëzisa granatash, 1 pushkë, 310 fishekë luftarakë, 12 krehra për armë zjarri, 2 radio marrëse-dhënëse dhe kapuça dhe veshje për mbulimin e fytyrës.

Shpërthimi që i morei jetën 56-vjeçarëit ishte i fuqishëm, as sa banorët thonë se u dëgjua në gjithë fshatin.



Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 14:44

Vrau babanë me tritol në Selenicë, kush është 23-vjeçari! Në polici tha se i ati i verbër e dhunonte

Mato Gllucaj, 23-vjeç është arrestuar nga policia e Vlorës, pasi dyshohet se vrau me tritol babanë e tij të verbër Durmish Gllucajn. Mato Gllucaj kishte vendosur lëndë eksplosive në oborrin e shtëpisë pranë sobës dhe në momentin kur i ati është afruar e ka shpërthyer përmes një mekanizmi elektrik. Sipas policisë 23-vjeçari dhunohej vazhdimisht prej kryefamiljarit.

M.Q./Shqiptarja.com

Share

M.Q./r.k./Shqiptarja.com

TAG: gjorm selenicë Mato Gllucaj durmish gllucaj Vlorë

Komento

Komente

Mirditori: 02/09/2023 14:58

Kuja ezeçi çfarë po ritim.Më vjen shumë keq për të ndjerin,u prefitë në paqe.Atë djalin ta varin për gjuhe.Por duhet të kuptojnj ju...pa përjashtim se përfundimi(rezultati) i kësaj propagande mediatike që mbiell vetëm dhunë(fëmiu,bajrne,emisione)me krim dhe SHUMË rallë kultur.

Përgjigju

e drejta: 02/09/2023 13:41

NUK E DI SE CFARE KA BERE I ATI I KETU KRIMINELI PER TE PASUR NJE VDEKJE TE TILLE, POR MUND TE THEM SE E KA EDUKUAR SHUME KEQ FEMIJEN E TIJ...PUPUPU KU KA ARRITUR NJERZIMI

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
Sipas jush opozita sezonin e ri politik do të jetë:

Më e fortë | Më dobët | Njësoj

Lajme të tjera

'Jusuf Arapët' e sotëm të Krorëzës
Josif Papagjoni
2 Shtator, 13:55

Drejtonte automjetin në gjendje të dehur, arrestohet Drejtori i Sigurimeve Shoqërore në Sarandë
2 Shtator, 00:20

Merr flakë në ecje 'Benzi' në Himarë, shpëton e reja! Shkak dyshohet një shkëndijë elektrike
1 Shtator, 22:38

Aksion 'blic' në Vlorë, Policia dhe Forcat Shqipona kontrolle në rrugët kryesore, në fokus eksponentë të krimit të organizuar
1 Shtator, 19:25

'RinCamp', 100 të rinj mblidhen në Dhërmi, ministrja Muzhaqi: Të zgjerojnë horizontet dhe të socializohen me njëri-tjetrin
1 Shtator, 17:07

VIDEO/ Zjarr në pyllin e Sodës në Vlorë, flakët pranë disa bizneseve, favorizohen nga era! Zjarrfikësit në vendngjarje
1 Shtator, 15:28

VIDEO/ Shpërthen soba e gazit, vdes 50-vjeçari i verbër në Selenicë
1 Shtator, 07:46

Kryebashkiaku i Vlorës për Report Tv: Qyteti ka pasur rekord turistësh, 26% më shumë se vitin e kaluar! Në 2025 synojmë fluturimin e parë në aeroportin e Vlorës
31 Gusht, 15:46

VIDEO/ Zjarr në kodrën e 'Kuzum Baba' në Vlorë, digjen bimësi e shkurre! Dyshohet i qëllimshëm
31 Gusht, 14:34

VIDEO/ Tensione në Këshillin Bashkiak të Vlorës, zgjatet kontrata për administrimin e Klubit të Futbollit Flamurtari
31 Gusht, 13:38

Turizmi/ Porti i Vlorës vendos rekordin e 30 viteve të fundit! 90 mijë pasagjerë udhëtuan në gusht me tragete
Armand Xhelili
31 Gusht, 12:59

Vlorë/ Iu gjet kallashnikov dhe municion luftarak në banesë, në kërkim 66-vjeçari në Selenicë
31 Gusht, 11:31

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje